



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



EKSTRAKT I PROCESVERBALIT
të dëgjimi publik për planifikimin e buxhetit për vitin 2022, mbajtur më 26.07.2022, me fillim në orën 14:00.

Të pranishëm ishin: Fitim Rexha, drejtori i Drejtorisë së Sportit, Valbona Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, Adrian Berisha, drejtor i Drejtorisë së Kulturës, Medina Braha, drejtoreshë e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Osman Bllaca, përfaqësues nga ekzekutivi dhe Hyzri Bunjaku, zyrtarë i lartë juridik nga Drejtoria e Arsimit.

Diskutimin e hapi dhe e kryesoi përfaqësuesi i ekzekutivit, Osman Bllaca.

Osman Bllaca theksoi se diskutimet për buxhet i kemi çdo vit, andaj edhe sivjet i kemi planifikuar dëgjimet buxhetore të planifikuara për vitin 2022 dhe linjën afatmesme, që është linjë afatmesme buxhetore për vitet 2022-2023-2024.

Më herët në kuadër të dëgjimeve i kemi mbajtur të përgjithshme, tani i kemi ndarë dëgjimet në kuadër të fushave, siç janë të kulturës, rinisë dhe OJQ-ve, për qëllim që me diskutuar më hapur me drejtor se si i planifikojnë këta mjetet dhe të ndahen nëpër fusha të ndryshme.

Adrian Berisha u shpreh se për mua është hera e parë që po planifikoj buxhet, së bashku me ekipet tona, për një vit buxhetor. Qëllimi ynë si Drejtori e Kulturës ka me qenë identifikimi i nevojave të qytetit dhe qytetarëve të Prishtinës. Kur jemi te nevojat, ne e dimë, duke marrë parasysh kapacitetet që i kemi, ato janë shumë të pakta, sa nevojat e lagjeve të qytetit në përgjithësi. Ideja jonë bashkë me juve dhe ekipet tona, përveç këtij takimi edhe në takimet e ardhshme me ju treguar saktësisht se çka kemi me planifikuar për buxhet.

Si drejtor i Kulturës në Komunën e Prishtinës, mendoj se fokus të veçantë do të kemi në këtë rutinë mund të krijojmë salla koncentrale, krijojmë salla baleti, qendra kulturore, por çka është e rëndësishme se qysh në vitin 2030 kemi me pasur individ dhe grupe të caktuara të shoqërisë, të cilat e dinë dhe veprojnë në mënyrë të duhur në fushën e kulturës Ne kemi me pasur programe të ndryshme të edukimit, të kulturës dhe për këtë kemi vendosur një buxhet, të cilin kemi me kontraktuar me kompani të cilat kanë me na ndihmuar, në mënyrë që me krijuar programe të aktiviteteve kulturore për shkolla fillore dhe të mesme.

Ky ka me qenë synimi kryesor i Drejtorisë së Kulturës, pastaj e kemi pjesën e projekteve që kanë me vazhduar, pastaj e kemi pjesën e mallrave dhe shërbimeve, subvencione ka një rritje të jashtëzakonshme dhe për vitin e ardhshëm synojmë të kemi 1 milion euro subvencione në fushën e kulturës në Komunën e Prishtinës. Se a do të pranohet kjo, varet prej buxhetit që e kemi prej Drejtorisë së Financave, prej kryetarit, Shpend Ahmeti, sepse kur i dorëzojmë ne drejtoritë buxhetin, ne e dorëzojmë buxhetin rreth 50 milionë euro më tepër sesa i ka kapacitetet Komuna e Prishtinës.

Valbona Makolli u përgjigj, duke thënë se ende nuk kemi kufi, ne sot jemi për kërkesat që i kanë qytetarët dhe sa mundemi ne me bërë realizimin.

Adrian Berisha theksoi se këtu janë dy përfaqësuesit e shoqatave kulturore në komunë të Prishtinës, ku problemi kryesor i tyre është hapësira për të ushtruar. Ne po planifikojmë që këtë vit me fut në buxhet, me pamundësinë e ndërtimit të një salle për shoqëritë kulturore të qytetit të Prishtinës, ku ato shoqëri kulturore kishin mundur me bëjnë një orar dhe kishin pasur dhomat e tyre për ushtrime.

Mehmet Xhemajli parashtroi pyetjen: -Kush e menaxhon ndërmarrjen "Pallati i Rinisë" dhe pse nuk është bërë asgjë?

Adrian Berisha u përgjigj se "Pallatin e Rinisë" nga viti 2018, është pronë e Komunës së Prishtinës. Në 2018 është planifikuar për vitin 2019 "Sonny Foundation", tash "Pallati i Rinisë" ndahet në tri pjesë : pjesa komerciale, pjesa kulturore dhe pjesa sportive, ku pjesës sportive i përket salla, ku shumica e klubeve veprojnë aty dhe salla e djegur planifikohet që të rinovohet te pjesa kulturore, duke përfshirë Sallën e kuqe, zyrat e "American School of Kosova", pjesën e atelesë dhe zyrat lart. Kemi qenë në diskutim me "Sonny Foundation" dhe "Boni Vetë" dhe me shkollën e mesme "Prenk Jakova", që ajo pjesë me u shndërrua në një qendër edukativo kulturore.

Siç e dimë, kemi pasur problem dhe fokusi i Komunës së Prishtinës ka qenë në 100% në menaxhim të pandemisë. Nga ky vit ne kemi me planifikuar linjë buxhetore të saktë, renovimin e pjesës kulturore të "Pallatit të Rinisë dhe Sportit", duhet me ditur se Komuna e Prishtinës, Drejtorja e Kulturës është ajo e cila e jep vendimin e fundit se si duhet të shfrytëzohet "Pallati i Rinisë", mirëpo duhet me ditur se të gjithë nuk i zë.

Mehmet Xhemajli theksoi se që nga vitin 2012 unë kam ushtruar në atë sallë, kanë qenë 10 asamble në qytetin e Prishtinës. Unë që nga viti 1985 punoj këtu në Komunë, prej 1985-1991, dhe prej 1999-2006 i di shumë mirë statistikat se kamë ushtruar vet, secili ansambël e ka pasur të ndarë sallën.

Adrian Berisha pyeti se kur u është ndaluar veprimtaria në atë sallë.

Mehmet Xhemajli dha sqarime.

Adrian Berisha pyeti se a ushtroni ju në njërin prej sallave, sa asamble ushtrojnë dhe a paguajnë për atë punë.

Mehmet Xhemajli tha se dy asamble nuk e paguajnë, por ka që e paguan sallën, se Prishtina është i vetmi qytet që nuk ka shtëpi të kulturës, është marrë objekti këtu që ka qenë Shtëpia e amatorëve është bërë çerdhe private.

Adrian Berisha theksoi se duhet të bisedojmë se ku jemi sot dhe qysh kemi me planifikuar për vitin 2022.

Mehmet Xhemajli tha se më intereson se çka do të bëni vitin e ardhshëm.

Adrian Berisha u shpreh se Drejtorja e Kulturës propozon në Pallatin e Rinisë, "Pallati i Rinisë" është ndërmarrje publike lokale, ata e kanë të drejtën e vendimmarrjes, aty është një menaxhment, aty është një bord dhe me mundur unë dhe Drejtorja e Kulturës krejt atë pjesë kulturore, e kishim larguar Prishtina Parkingun, çerdhen dhe çdo institucioni të pavarur kulturor i kishim dhënë nga

një dhomë 30 m me shfrytëzuar për me ushtruar. Ju kemi propozuar, por nuk janë pajtuar deri sa të bëhet ai masterplani.

Mehmet Xhemajli tha se që 30 vjet nuk kam marrë lekë që i kam ushtruar nxënësit, kishte me qenë mirë nëse hapet një institucion kulturor, ku fëmijët nuk do të kenë kohë me u marrë me punë të këqija, këtë qëllim duhet ta kuptoni. Në atë kohë vetëm disa asamble kanë qenë, të gjitha i kanë pasur instrumentet, gardërobën, sallat ku kanë ushtruar, 10 kanë qenë në Prishtinë.

Adrian Berisha tha se linja kryesore e Drejtorisë së Kulturës ka me qenë 500 mijë euro, ku ka me u angazhuar një kompani proporcionale, e cila ka me i krijuar d.m.th. programet dhe aktivitetet kulturore për shkolla fillore dhe të mesme, ku kanë me u përfshi vallëzimet e ndryshme, teatri, muzeu, muzika, aktrimi.

Ne e dimë gjendjen, nëse keni propozime konkrete na tregoni dhe ne i shqyrtojmë.

Mehmet Xhemajli parashtroj pyetje: - Pse nuk është hapur asnjë ansambël në qytetin e Prishtinës?

Adrian Berisha dha sqarime lidhur me këtë pyetje.

Mehmet Xhemajli dha një propozim, që nga buxheti për kulturë që ndahet për vitin e ardhshëm që e miratoni, 20% të atij buxheti mos me u dëmtuar ekstra me kërkuar për punëtorë, ligji e thotë shumë mirë, thotë se një drejtor punësohet, tjerët nuk kanë nevojë mu punësuar, mund të ndodh me i marrë edhe si bashkëpunëtorë të jashtëm me mëditje, përndryshe është shumë mirë e definime me ligjin që është miratuar në vitin 2015 në Kuvendin e Kosovës për ansamblin "Shota" dhe ansamblet tjera.

Adrian Berisha tha se ne e kemi synimin me i krijuar dy ansamble, kemi me bërë kërkesë dhe kemi me planifikuar, dy ansamble dhe një beng, Ansambli i valleve të qytetit të Prishtinës, i këngëve dhe valleve, dhe ansambli "Rexho Mulliqi". Te ansambli "Rexho Mulliqi" kemi me kërkuar me qenë 15 persona, ndërsa në këngë e valle bashkë me menaxhmentin 10, ndërsa në "Prishtina Bing Beng" kemi me kërkuar me qenë 15 persona, gjithashtu kemi me kërkuar në teatrin "Dodona" si kryeqytet me i pasur edhe 10 aktorë të rinj.

Skënder Thaqi e falënderoi drejtorin për bashkëpunimin, tha se na jepni një shumë për aktivitet dhe ju e dini ligji nuk lejon me na dhënë gjatë vitit, çka me bërë me atë shumë?!

Kam një propozim konkret. Aktivitetet kur t'i mbështetni ndani në dy pjesë, katër shoqëri janë, dy shoqërive në gjashtëmujorin e parë të vitit jepja nga 4 mijë e në pjesën e dytë të vitit tjetër.

Unë e mbajë një festival të vogël që 6 vjet, nëse keni mundësi me ma mbështetë me teknikë, nuk po kërkojmë mjete.

Adrian Berisha tha, siç e dini, ndarja e subvencioneve është në Ligj për subvencione, se një projekt mund të mbështetet vetëm 2% nga shuma totale, e shumë totale që e planifikon institucioni për me i dhënë subvencion gjatë vitit, në OJQ mundemi t'i mbështesim vetëm një here gjatë vitit, kjo është rregullorja që është miratuar në Kuvendin e Komunës, kjo rregullore mund të ndryshohet në të ardhmen nëse ju insistoni.

Skender Thaqi tha se nuk është problemi vetëm te rregullorja, sepse rregullorja nuk thotë ndani pak për shumë.

Adrian Berisha premtoi se do të përpiqet që të jepen subvencionet në Drejtori të Kulturës, me rritur buxhetin në 1 milion euro, kjo është që kemi me tentuar me bërë dhe mos me qenë pak për shumë por shumë, d.m.th. për disa projekte të cilat konfirmojnë, për mendimin tim më mirë është me u zgjedhur dy projekte më të mirat dhe me iu dhënë buxhet nga 8 mijë euro.

Skender Thaqi pyeti se a mundemi përmes juve që po doni me rritë qatë 2% në 4% dhe nëse keni me rritur në 4% keni me na dhënë të gjithëve.

Fitim Rexha dha sqarime.

Adrian Berisha tha se Ligji për subvencionimin e projekteve bujqësore, kulturore, arsimore, në mirëqeni sociale është Ligji i cili duhet të ndryshohet në Kuvend të Kosovës, ne jemi takuar me Ministrinë e Kulturës ju kemi thënë kjo është gabim, Ministria e Kulturës është në përpilim të Ligjit për kulturën, është tu bërë një hapë zakonisht, hap që njerëzit nuk kanë me parë, por pas një vite e gjysmë do me thënë ka mu bërë ky Ligj, na kemi me ja parë hajrinë edhe ju shumë.

Skender Thaqi shprehu dëshirën që drejtori i Kulturës të zgjidhet edhe për një mandat e të realizohen idetë për t'i shtyrë këto komunitete që i përmendet, mirëpo nuk duhet ta bëjmë një ansambël komunal "Minatori", sepse nëse i grumbullojmë të gjithë i bëjmë bashkë, jemi në rregull nëse e vejmë emrin e një ansambli, nesër, pasnesër vjen tjetri dhe thotë pse nuk është i yni.

Adrian Berisha u shpreh se e dimë që ansambli më i vjetër që fushë vepron në qytetin e Prishtinës është ansambli "Bajram Curri". Përveç që është më i vjetri, ata veprojnë privatisht, ai nuk është i Komunës së Prishtinës, ne kemi menduar që me bërë Ansambël të Qytetit të Prishtinës. Ligjërisht kemi të drejtë, edhe pse ne si Komunë kemi të drejtë ligjërisht me ia marrë emrin dhe ne nuk kemi me iu thirr juve, kemi me bërë konkurs publik për drejtor, për sekretar, dhe ky ansambël ka me bashkëpunuar me juve se ju jeni në këtë qytet.

Fatos Dili shprehu falënderim për drejtorinë e Kulturës. Ai tha se që nga viti 2015 ekzistojmë si klub, e kam pasur një përkrahje personale, kjo nuk do të thotë që të gjitha veprimtaritë sportive në komunë të Prishtinës janë të kënaqura. Do të ishte mirë që klubeve të sportit me iu bërë me dije se si po njoftohen përmes e-mailit për subvencione, me ua bërë edhe një kritikë, që nuk po vijnë këtu dhe me i dëgjuar hallet e tyre. Sikurse në kulturë edhe në sport problemi qëndron i njëjtë, janë 10 ekipe klube të karatesë, unë nuk bëjë pjesë te karateja, por i shoh, njëri i ka 3, tjetri 5, tjetri 8, pse këto hasmëri?! Po të kishin qenë 40-50 klube të karatesë, kishin pasur mundësi edhe me renovuar sallën më mirë dhe me pasur financa.

Unë jam drejtor sportiv i licencuar, nuk mundet një shkollë e futbollit me 5 trajnerë me i edukuar me ju mësuar a, b, c-në e futbollit 300 nxënësve brenda ore. Ata duhet me pasur një grup të caktuar prej 20 vetëve, pavarësisht që e lejon edhe Federata e Futbollit, 2 Korriku A, 2 Korriku B etj., të njëjtën gjeneratë e kanë për me ju marrë para fëmijëve.

Po dua me dal më konkretisht, që unë e shohë në listën e subvencioneve ka shkollë, është mirë me bërë një ndarje mes klubit dhe shkollës, me bërë si praktikë.

Fitim Rexha tha se shkolla "2 Korriku" është OJQ, nuk është privat, vetëm "Prishtina" dhe "Flamurtari", nuk ka të tjera privat.

Fatos Dili tha se unë po flas si OJQ, ku i ka 350 fëmijë dhe i merr 40 euro për fëmijë dhe e ka terrenin e komunës së Prishtinës, është toka e Komunës, zero centë, renovimin e ka bërë Komuna e Prishtinës, Ministria e Sportit ia ka bërë fushën e madhe, Ministria e Sportit me Kujtim Shalën ministër, ia ka bërë fushën e vogël dhe klubi i futbollit "Prishtina".

Është mirë me ju thënë edhe klubeve që luajnë dhe shfrytëzojnë aktivitete në Pallat të Rinisë, me iu treguar se e keni një subvencion që nuk e shihni, se ne nuk paguajmë në Pallatin e Rinisë.

Fitim Rexha theksoi se regjistrimi i klubeve nuk bëhet prej Komunës së Prishtinës, ne i regjistrujmë në Komunë të Prishtinës, por kur Ministria ia jep certifikatën, kjo nuk është problematikë e thjeshtë, kjo problematikë nga lart vjen te ne, ne duhet me i zbatuar ligjet e tyre.

Fatos Dili tha se si janë caktuar 10 pika si kriteret për t'i marrë subvencionet, dhe duhet me i raportuar ato me qitë edhe një pikë. Nuk mundesh me subvencionuar nëse je klub kolektiv dhe nuk i ke mbi 15 ose 20 anëtarë.

Po ashtu, tha çka është e mundur me ju ndihmuar klubeve, është që sallat edukatës fizike nëpër shkolla mbas orarit të mësimi me pasur mundësi të shfrytëzimit të tyre.

Fitim Rexha tha se për këtë duhet me iu drejtuar Drejtorisë së Arsimit.

Adrian Berisha tha se Ministria e Arsimit është duke bërë një projekt për salla të sportit dhe tash janë në finalizim për përzgjidhje të projekteve më të mira.

Naser Krasniqi tha se të gjithë e kemi një problem, si ata të kulturës, si na të sportit e kemi infrastrukturën sportive, të cilën infrastrukturë edhe këtë që e kemi nuk kemi duke e shfrytëzuar në mënyrë të barabartë.

E përfaqësoj një klub që është ma i suksesshmi në Kosovë, ka 9 tituj të kampionit, është "Prishtina", por tash mundësitë na i kanë dhënë me emrin "Kven Teknologji", në bazë të sponsorit që e kemi. Ne kemi pasur takim bashkërisht, është problemi i Pallatit të Rinisë. E kemi një Pallat, por të gjithë po dëshirojmë me hy aty me ushtruar, por nuk po i kemi mundësitë. Ne nuk kemi qasje fare, ne shkojmë i improvizojmë disa salla nëpër shkolla dhe vetë kemi investuar në salla dhe kemi prapë problem me i shfrytëzuar po të njëjtat salla që kemi bërë investime. Edhe na jemi OJQ, në sallën "1 Tetori" ne zhvillojmë aktivitetet dhe për këtë ne paguajmë, kjo nuk është e drejtë mos mi takuar Komunës së Prishtinës, se është faktikisht palestër e Komunës së Prishtinës, jo e Qendrës së Studentëve.

Prishtinës i duhet një palestër, ose mu bërë e sportit femëror, sepse donë përkrahje më shumë, e cila nuk kushton ma tepër se 200-250 mijë euro, në mënyrë montazhe kishte mundur me u bërë në çdo vend.

Sa u përket subvencioneve, unë asnjëherë s'kam pasur ndihmë më të madhe sesa kjo garniturë që ka ardhur, e cila me subvencione i ka ndihmuar shumë sportit, po flas konkretisht, për volejball, tash ka ndërruar në mënyrë drastike.

Vërejtja ime është për ndarjen e subvencioneve, p.sh. klubi im është klubi i cili nga Komuna është shpallur klubi më i mirë për vitin e kaluar dhe merr subvencione 100% më pak se një klub tjetër, por nëse nuk kemi një specifikim të ndarjes së buxhetit, jo me shkuar me shoqëri, është e padrejtë me na ndarë neve aq pak buxhet, kur kjo Komunë vetë na shpall klubin më të suksesshëm, andaj nuk kemi të kënaqur me ndarjen e subvencioneve.

Ne në volejball e kemi problem infrastrukturën, nuk kemi qasje si klub si të tjerët në "Pallat të Rinisë" dhe me na bërë një zgjidhje, që tha me ministrin e Arsimit duhet me ardhur me biseduar posaçërisht, se mundet edhe nëpër shkolla me na mundësuar, me na lejuar qasjen 2 - 3 here në javë.

Adrian Berisha pyeti se sallës së sporteve me duar a ka me ju mundësuar klubeve që me ushtruar aty, apo vetëm me u bërë lojë.

Fitim Rexha dha sqarime edhe për sallat ndihmëse.

Sa i përket subvencioneve, Naser ne i kemi ndarë në dy lloje subvencione, nuk janë subvencione të ndryshme, pjesa që është ndarë përmes Kuvendit të Komunës është shkuar si një shabllon: 50 mijë euro basketbollit, 30 mijë euro hendbollit dhe 20 mijë euro volejbollit.

Sa i përket Pallatit, sugjerimet prej Drejtorisë së Sportit kanë qenë që në Pallat me shkuar sipas hierarkisë, klubet e superligës janë të parat, nuk mundet dikush tjetër i ligës së dytë me ta zënë vendin tash, sugjerimi sipas drejtorisë ka qenë ky.

Ne jemi në përpilim të atij memorandumit - marrëveshje, që me bërë me Pallatin me u paguar shpenzimet e klubeve që i frekuentojnë ato, klubet e Prishtinës, do të bëhet subvencionim indirekt, që ju nuk e keni më atë problem, kështu që një marrëveshje drejtori - klubi sportiv dhe Pallati vërtetohet ajo marrëveshja dhe shpenzimet e juaja janë të kryera.

Salla e sportit, unë besoj se në dy vitet e ardhshme duhet me qenë e kryer, që është një zgjidhje. Po ashtu ceku se Shpend Ahmeti ka qenë me një kontratë shumë përfaqësues prej Emirateve të Bashkuara, që Pallati i Rinisë me u funksionalizuar i tëri, por për shkak të pandemisë ka dështuar ajo.

Naser Krasniqi theksoi se unë nuk e di çfarë qasje ka Komuna në sallën "1 Tetori". Ajo palestër shfrytëzohet në mënyrë jo adekuate, investimet që janë bërë aty nuk janë bërë në Pallatin e Rinisë, andaj a ka procedurë që u nisë me u kthyer në favor të Komunës, se ne e dimë se ajo i takon Komunës. **Fitim Rexha** tha se kjo mundë të bëhet me një vullnet të mire prej Ministrisë përkatëse edhe prej Komunës, këtu ka pasur iniciativë edhe prej Shpendit, nuk është që nuk ka pasur, por ka hasur pak në kundërshti.

Fatos Dili pyeti se a ka mundësi kjo faza kur hapen subvencionet, me mundur me koordinuar që me u hapur kur klubeve iu duhen që mos me na shti në obligime, p.sh. ne i lypim paratë në shtator e ato shkojnë deri në janar, e në janar ne jemi në pushim.

Fitim Rexha tha se duhet të ndiqen procedurat ligjore.

Një qytetar tjetër tha se më vjen mirë që ja ka nisur salla me u ndërtuar, ne kemi ardhur me bërë një kërkesë nga komunitetet për sallë ekstra shtesë. Në rast se nuk gaboj, në Prishtinë janë 820 klube të regjistruara, pas dy vite ndoshta ka me kaluar edhe 1000 apo 900, sidoqoftë krejt këto klube kanë me pasur nevojë për hapësira, edhe ajo sallë mbas 1 viti apo 2 vite kur të kryhet, ka me qenë e pamjaftueshme për numrin e klubeve që është duke u rritur, janë duke u bërë sporte të reja, kështu që duhet shtuar buxheti, që kur vije puna me hequr të hiqet kjo kërkesa jonë, së paku me pasur edhe një sallë tjetër.

Po ashtu, tha se e ceku më herët Naseri, që me parashtruar kërkesën edhe sa i përket ushtrimeve nëpër shkolla, por sa i plotësojnë kriteret klubet te ato salla.

Hyzri Bunjaku dha sqarime.

Fatos Dili tha se shkolla "Model" i plotëson kushtet për volejbol, me shkollën Model i rehaton minimumi prej orës 17:00-24:00, me i hequr terminet që luan dikush futboll për qejfi, i kryen volejbollin krejt me femra dhe meshkuj. Në Shkollën "Xhemajl Mustafa" aty ka mundësi shkollë me shkollë.

Hyzri Bunjaku pyeti se a jeni të kënaqur me pagesën, d.m.th. pjesën e pagesave, kur keni bërë kërkesë në DKA dhe iu ka lejuar ju nuk paguani, por të tjerat dikush duhet me paguar.

Fatos Dili tha se shkolla e cila ushtron fëmijë dhe fiton të hyra, është obligative me paguar.

Hyzri Bunjaku tha se Rregullorja e Komunës thotë për shfrytëzim s'ka lidhje a paguan a jo.

Naser Krasniqi ceku punën e mirëmbajtjes, duke thënë se unë jam merituar që parketi i vjetër të cilën kompania ime e ka punuar në Pallat të Rinisë, e kam ruajt të vjetrin dhe e kam vendosur në një depo, pastaj i kam njoftuar shkollat që ta marrin. E kanë qitur një tender, unë i kam bërë kërkesën Këshillit të Prindërve dhe kam marrë atë palestër me shfrytëzuar tri here në javë. Kjo vazhdon që dy vite, i kam vendosur dritat vetë, e kam gërryer prapë parketin, banjot i kam rregulluar, më kanë kushtuar

diku 5-6 mijë euro, dhe këtë vit qohet një profesor i edukatës fizike më thotë se ti nuk ke me ushtruar më këtu se është pandemi, duhet marrë një miratim prej Drejtorisë së Arsimit.

Hyzri Bunjaku tha se unë pyeta a është në rregulle, a i kryejnë funksionet këto palestra për ushtrimet e juaja, shuma, unë mendoj personalisht për këtë, po dua me ju pyetur a është e madhe, mundet me qenë më e vogël, që me qenë më e përballeshme për disa klube më të vogla, me marrë njëfarë mendimi me diskutuar me DA-në dhe me nxjerr ose një vendim të përgjithshëm, ose me shkuar me aplikime individuale dhe ju me pasur pëlqimin paraprak, dhe ku të shkoni ju me bërë ushtrime me pasur realisht të siguruar.

Fjalën e morri një qytetar tjetër, i cili tha se më herët tha drejtori se mundet me u përzier në çështjen e sallës, tha edhe më herët se i takon drejtoritë të shkollës, Ministrisë Arsimit, a vendosin ata me mirëmbajtje, për arsye se punëtori nëse e ka orarin deri në ora 18:00, duhet me pastruar atë sallë, nuk të rrinë punëtori deri në orën 20:00 me ta lënë sallën hapur se është përgjegjësi, është normale se për klube të mëdha u tha nëse japin nga 20-30 euro, tri klube nga 20 -30 euro me ia dhënë një pastruesi për mirëmbajtjen e sallës.

Fatos Dili tha se ne nuk aplikojmë në Ministri të Financave, por në Drejtori të Sportit. Drejtorja e Sportit i kryen procedurat për me na i qitur paratë neve, mua më intereson me ushtruar, si gjendet rruga le të gjen institucioni, të cilave ju kemi besuar, dhe drejtorëve që na po i besojmë. Shumë mirë na e dha përgjigjen, me një drejtor të kaluar i ke pasur rrugët e hapura, me një drejtor të ri që nuk po kupton, janë dyert e mbyllura.

Fjalën e mori një qytetarë tjetër, duke folur si zyrtar i Federatës së Atletikës, duke thënë mos t'i këqyrim fëmijët a shkojnë në shkollë apo në klub, nëse një fëmijë shkon me vrapuar në një klub të atletikës ai mëson aty. Mësimi është shkollë, nëse një fëmijë shkon në volejboll, ai është klub, ai po shkon me mësuar, është shkollë. Unë e përgëzoj klubin "2 Korriku", që ka arritur me i larguar 350 fëmijë prej rrugës, është meritë e madhe.

Fatos Dili tha se ju e dini, unë nuk pajtohem me politikat e klubit të futbollit, por "Prishtina" ka pesë vjet ka luajtur në Pejë, se "2 Korriku", "Flamurtari" nuk ua kanë lëshuar fushën e është dashtë me shkuar në Pejë.

Fitim Rexha tha se klubet tona janë jo profesionale. Me pas ardhur klubi futbollistik "Prishtina" te Shpendi a te unë, a dikush tjetër, nuk kishte pasur qare "2 Korriku" ose "Flamurtari" pa ia lëshuar atë fushë, se është me Ligj, se unë kur dua e shfrytëzoj atë fushë, por nuk i ndjekin hierarkitë. Çdo klub që ka ardhur ka diskutuar me ne, i është zgjidhur çështja.

Fjalën e morri një qytetar tjetër, duke iu drejtua drejtoreshës së Financave. Unë jam në sport të notit, ne kemi problem sidomos pishinën e notit. Pasi që është faza e shtrirjes së gypave të nxehjes qendrore nëpër qytet, kishte qenë mirë me planifikuar me lënë disa gypa për një pishinë të qytetit, e cila do të mund të hynte tash në planifikim të buxhetit.

Problem tjetër si klub, kemi edhe me infrastrukturën e zyrave, veç e ceku drejtori se ka qenë në plan me u bërë në Pallat të Rinisë, me pas mundësi me pas një hapësirë në Pallat të Rinisë, zyrat dhe ushtrimeve kur është koha e keqe, se ne mblidhemi në stadium te atletikës që është në Prishtinë, por kishte qenë mire me i pasur si kërkesa tona në të ardhmen.

Qytetari tjetër pyeti se a keni informatë kur pritet të bëhet renovimi i Pallatit të Rinisë, apo kjo varet prej bordit të Pallatit, se po kemi problem me një gyp të kanalizimit sa here po bie shi.

Fitim Rexha bëri të ditur se kur e ka paraparë planifikimin e buxhetit të vitit të kaluar, anëtari i bordit të Pallatit ka qenë aty dhe është dashur me paraqitur kërkesën, ai ka thënë nuk kam nevojë asgjë.

Mentor Morina tha se siç e përmendi edhe zotëri Naseri, më së shumti ka punuar, e kanë përkrahur sportin, edhe unë kam problem me infrastrukturë. Unë jam në sallë, por shumë vonë nuk ka mundësi me ushtruar më herët për shkak të klubeve tjera, boksi ka prioritet, unë filloj në ora 21:30, ku kam fëmijë, por prindërit çdo herë ankohen se ushtrimet mbahen shumë vonë, d.m.th. është problemi i infrastrukturës.

Fitim Rexha u shpreh optimist, duke thënë se ajo marrëveshja që po interesohemi ta bëjmë e zgjidh këtë problematikë deri diku.

Mentor Morina tha në Fushë Kosovë ka luajtur pak xhudo Majlinda Kalmendi, Driton Kukaj e kanë bërë sallën, e kanë Sutki Veseli dhe Berisha e shfrytëzojnë vetëm për sporte luftarake, Fushë Kosova e ka, Prishtinë jo.

Fatos Dili tha se Obiliqi e ka palestrën, ku janë shpenzua 3 milionë 500 mijë euro. Unë nuk kam pasur vende, më është dashur me shkuar atje, po më kanë thënë hajde 20 euro e ke orën.

Ai parashtoi pyetje se a munden me marrë pjesë në debatin për arsim.

Valbona Makolli tha se mundeni me ardhur dhe me biseduar me drejtoreshën e Arsimit dhe stafin e saj.

Qytetari tjetër bëri vërejtje, duke thënë se se i kam dërguar mbi 20 e-maile, ku iu kam drejtuar drejtoreshës së Arsimit dhe i kam shkruar se nuk kemi pasur ku ushtrojmë, jo që nuk e ka marrë mënyrën me thënë jo, as email-in nuk ma ka kthyer, mirëpo më ka ardhur e-maili prej një zyrtari të Komunës dhe më ka thënë ju keni mjete. Me ardhur kësi emaili është skandaloze!

Valbona Makolli i falënderoi pjesëmarrësit që kanë gjetur kohë me ardhur në dëgjim publik.

Debati përfundoi në orën 15:30.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina



EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të dëgjimi publik për planifikimin e buxhetit për vitin 2022, mbajtur më 27.07.2021me fillim në orën 14:00.

Në diskutim publik ishin të pranishëm: **Valbona Makolli**, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, **Shpresa Shala**, drejtoreshë e Drejtorisë së Arsimit, **Isa Avdiu**, **Arbër Gashi** dhe **Ridvan Islami**, zyrtarë nga Drejtoria e Arsimit.

Valbona Makolli i përshëndeti të pranishmit, duke i falënderuar për pjesëmarrje në dëgjimet publike për planifikimin e buxhetit për vitin 2022. Ajo tha se ne jemi për t'ju dëgjuar për projektet e vitit 2022, d.m.th. i dimë përafërsisht hallet e juaja, ankesat dhe kërkesat, por sot jemi për të dëgjuar propozimet tuaja për investimet kapitale që lidhen me fushën e arsimit.

Shpresa Shala, i përshëndeti të pranishmit, duke thënë se sot po takohemi për t'i marrë kërkesat e juaja, se këtu është mundësia për t'i vendosur kërkesat tuaja në raport me shkollat ku jeni.

Isa Avdiu theksoi se buxheti për vitin 2021 ka kaluar, por i njëjti është edhe për vitin 2022. Për paga i kemi 18 mijë, 2 milion 600 mijë për IK, stafi është i njëjtë, por nuk di a kemi mundësi me rritur stafin tani, "mallra shërbime" është njësoj si vitin e kaluar, "kapitalet" gjithashtu diçka i kemi të rritura për 1 milion euro të planifikuar për 2022. Nëse e keni ju ndonjë projekt paraqiteni këtu, projektet janë të njëjta si vitin e kaluar, nëse nuk bëjmë ndryshime, pajisja e bibliotekave, furnizimi me kamera, rregullimi i oborreve, rrethojave, ndërtimi i shkollave, i çerdheve etj.

Valbona Makolli theksoi se projektet të cilat i ceku kolegu e të cilat projekte nuk kanë filluar për shkak të shkaqeve të ndryshme, vjet ka qenë problemi te pandemia, kështu që projektet që nuk janë realizuar duhet me hyrë prapë në projektim me vazhduar dhe nuk mundemi me bërë projekte të reja.

Musli Gashi, drejtor i shkollës "Avni Rrustemi", **Mramur**, i përshëndeti të pranishmit dhe falënderoi për këtë mundësi që u është dhënë si staf i shkollës me dhënë mendime dhe propozime për prioritetet që ne i shohim çdo ditë.

Unë i kam paraqitur me shkrim kërkesat të cilat i ka bërë shkolla jonë në vitin 2019 - 2020 - 2021, unë i kam disa pika me të cilat ballafaqohemi çdo ditë:

- Rregullimi i hapësirës së jashtme në oborrin e shkollës, të ndarë në Lagjen Halilaj, kërkesë e theksuar se nuk ka shkolla oborr, po ashtu e kemi problem edhe peletin për ngrohje kur e ofrojmë te depoja, duhet me lënë në rrugë kryesore dhe me bartur gjithherë me punëtorë.

Isa Avdiu pyeti se sa metra katrorë mund t'i ketë oborri i shkollës.

Musli Gashi tha se me sa e di unë, 9 arë janë komplet, është fjala për paralelen e ndarë në lagjen "Halitaj".

Për shkollën "Avni Rrustemi" në Mramur kemi shumë kërkesa:

- Dyert e dritaret i kemi shumë të vjetra, i kanë mbi 35 vjet;
- Rregullimi i murit mbrojtës mbrapa sallës së edukatës fizike, e kemi parë se është në projekt;
- Vendosja e kamerave sigurisht do të bëhet vitin e ardhshëm.
- Kemi me kërkuar staf teknik se sallën e kemi ndërtuar, nuk kemi staf teknikë me mbuluar për me pastruar sallën. Salla është ndërtuar, por rrjedhjen e ujit aty nuk kemi mundur me ia ndalur kurrë prej kulmit dhe e ka dëmtuar një pjesë të murit.
- Në paralelet në Suteskë e kemi një pjesë të lumit që e gërryen atë pjesën e sallës-fushës sportive.
- Kemi 12 -13 metra të trotuarit me baltë prej rrugës kryesore, që shkon deri te trotuari që të vazhdon deri në shkollë, po të ketë mundësi të bëhet me kubze.

Myrvete Tahiri, drejtoreshë e shkollës "Zenel Salihu", shprehu shqetësimet që kanë të bëjnë me shkollën që menaxhon, e cila është shkollë mjaft e vjetër, e ndërtuar në vitin 1964, janë bërë disa herë renovime, por është e vjetër, ku kemi qarje horizontale dhe vertikale në mes, në korridore:

- Energjia elektrike nën kulm është e zhveshur tërësisht;
- Dritaret janë të gjitha të mbyllura me gozhda;
- Nxehja qendrore nuk kryen punë për shkak të dritareve që nuk mbyllen mirë;
- Klasat janë të pagëlqerosura etj.
- Në kulm disa herë është ndërhyrë, por çdo herë që bie shi pikon në korridore dhe si pasojë kemi mykjen e korridorit.

Duke pasur parasysh të gjithë këta faktorë, kishte qenë mirë të bëhet ndërtimi i një shkolle të re, pasi që ka hapësirë të mjaftueshme.

Feim Osmani, kryetar i BL-le në Besi, parashtroi një pyetje dhe një kërkesë.

- Kërkesë për shkollën në Besi. Kjo shkollë ka njëfarë hapësire, mirëpo duke pasur parasysh numrin e madh të nxënësve, që janë mbi 700 nxënës, mund të them se është mbetur ndoshta shkollë e vetme në Prishtinë që nuk është ndërtuar e re. Ky objekt nuk i plotëson kushtet e përfaqërta për një mësim si duhet.

- Nuk ka sallë të edukatës fizike brenda;
- Nuk ka asnjë kabinet të cilësdo lëndë, përveç një të biologjisë 2x3 m dhe një bibliotekë të vogël, me një fond të vogël të librave.

Për shkollën Vranidoll si janë procedurat, a ka afat të përfundimit apo ka me vazhduar vetëm ky gjysmëvjetor dhe vitin tjetër me i dërguar fëmijët në shkolla tjera se puna po shkon shumë ngadalë?

- Në shkollën paralelja e ndarë në Prugovc, në pjesa e brendshme ka hapësirë për investime shumë, banjat nuk funksionojnë mirë.

Shpresa Shala theksoi se shkolla komplet është rinovuar, banjat i kemi bërë të reja.

Feim Osmani tha se shkollat kanë pasur probleme me thyerje sa ka qenë nxehja me naftë, kështu që montimi i kamerave të sigurisë kishte me qenë puna më e mirë.

Shpresa Shala dha sqarime.

Arbër Gashi dha sqarime se sistemi i alarmimit është proceduarë, tani ka me u marrë prej kompanive private, kanë me u siguruar komplet objektet me aksesore, kështu që shpejt pritet të bëhet një zgjidhje.

Subije Zhitija, drejtoreshë e shkollës "Gjergj Fishta", falënderoi drejtorinë për mundësinë e dhënë për këtë dëgjim publik, duke thënë se këtu u cek çështja e edukatës fizike, por këtë a me konsideruar si problem, apo si punë të kryer.

Valbona Makolli tha se kanë hyrë në fonde me rezervë, se i kemi kaluar me total dhe kërkesa e tyre është me i ndarë pjesë për pjesë, Drejtoria e Arsimit veç e ka kryer atë pjesë, ka mbetur në investime kapitale një pjesë me kryer, me qitur prapë në Kuvend me nisur procedurën prej fillimit e mi dërguar në Ministri të Financave.

Shpresa Shala tha se nëse nuk mundemi me i kthyer prapë, i kemi me shkollën "Gjergj Fishta" edhe shumë shkolla të tjera edhe ato renovimet tjera që jemi dakorduar. Po ashtu, ceku se dyshemetë shkojnë me neve. Vitin e kaluar më së shumti kemi pasur renovime në shkollën "Zenel Hajdini", ka pasur renovimi në dysheme dhe sallë të edukatës fizike.

Subije Zhitija tha se fusha e jashtme e edukatës fizike dhe kubzet në oborrin e shkollës janë kërkesa të domosdoshme.

Myrvete Tahiri, drejtoreshë e shkollës "Zenel Hajdini", tha se ka pasur renovime në dysheme dhe salla të edukatës fizike, por ndërtesa është shumë e vjetër dhe po kemi probleme.

Subije Zhitija tha se shkolla ka nevojë shumë për inventar - banka të reja. Me sa e kuptova, qenka kontrata për televizorë, ne disa i kemi siguruar përmes garantit të Bankesë Qendrore.

Shpresa Shala tha se ne e kemi një listë, ku në bazë të numrit të nxënësve do të ndahen televizorët, por çdo klasë nuk do të ketë televizor.

Shemsedin Beqiri, drejtor i gjimnazit "Eqrem Çabej", shprehu shqetësime për problemet me të cilat po ballafaqohet kjo shkollë.

- Çështja e kulmit kur kushtet klimatike janë të rënda, siç i patëm reshjet e rrëmbyeshme të shirave para disa ditëve, aty është vërtet si mos me pasur kulm fare ajo shkollë;

- Dritaret janë të dobëta në shkollë, nga pjesa veriore po ashtu ndërrimi i disa dritareve të korridorit, veçanërisht nga salla e edukatës fizike, nga kabinetet e shkollës, po ashtu është problem edhe ngrohja e shkollës për shkak se dritaret nuk mbyllen mirë;

- Vitin e kaluar kemi bërë kërkesë për 23 dyer të klasave, përgjigje nuk kemi marrë;

- Me inventar gjithashtu nuk jemi siguruar mjaftueshëm;

- Në pjesën veriore të shkollës është i domosdoshëm ndërrimi i dritareve të aluminit, që nuk kanë kurrfarë efekti.

Në shkollë e kemi vështirë me zhvilluar aktivitet të lehtë me këto kushte.

Haxhi Metaj, drejtor i shkollës "Ahmet Gashi", bëri të ditur se edhe ata kanë pasur probleme sa i përket dritareve të vjetra, mirëpo me shtëpiakët e shkollës i kanë rregulluar vetë.

Problemi që e kemi ne është, me pasur mundësi me projektbuxhetin e vitit 2022, të kemi një fond të shkollës. Njëherësh ai pyeti se a ka mundësi ne me bërë një kërkesë që arkivin që gjendet aty me dërguar diku tjetër, e ne me marr atë pjesë se kemi nevojë shumë.

Fatlinda Karahoda falënderoi drejtoreshën e DKA –së për bashkëpunim, e cila për çdo kërkesë që ia kemi drejtuar ka treguar gatishmëri me na ndihmuar.

Kërkesat për shkollën tonë janë:

- Shkolla ka nevoj për gëlqerosje;
- Salla e edukatës fizike e ka një mbulesë të plastikës, të rrëshqitshme, që është rrezik për nxënës, andaj dyshemeja të jetë e përshtatshme;
- Tualetet të cilat janë të reja, të cilat asnjëherë nuk janë përdorur për shkak se rënia e ujit të kanalizimit nuk është si duhet dhe uji po kthehet prapa;
- Shkallët emergjente të planifikohen për vitin 2022;
- Furnizimi i kabineteve të infermierisë, rregullimi i kabinetit të farmacisë, furnizimi i një barnatoreje.

Ridvan Islami tha se jemi duke e pritur projektin prej juve, drejtoreshë.

Jeta Dida – Bujari, drejtoresh e shkollës së muzikës “Prenk Jakova ”, falënderoi drejtoreshën e DKA-së për bashkëpunim.

Shqetësimi për shkollën tonë është objekti i shkollës, i cila ka traditë 72 vjeçare dhe është ndër shkollat e para profesionale dhe ende nuk llogaritet si shkollë, mbetet në këtë shekull pa objektin e vet, që për mua vërtetë është e pakuptimtë jo vetëm për mua, por për të gjithë instrumentistët kosovarë për gjithë komunitetin artistikë në Kosovë.

Ju kisha lutur në emër të gjithë komunitetit artistik, të bëhet prioritet Shkolla e Muzikës.

Ju përmendët disa prej shkollave, ndërsa shkolla jonë nuk u përmend fare. Kësaj shkolle duhet t’i jepet prioritet, se po bëhet një shkollë me 900 nxënës, d.m.th. çdo ditë po rritet numri. Këtë vit kanë konkurruar 317 nxënës, ku më parë ka qenë numri 120-180 fëmijë që kanë konkurruar.

Kemi edhe disa gjëra të vogla që kemi nevojë, si bankat, karriget. Kemi bërë kërkesë te ju, edhe vetëm me 6 televizorë e kryejmë ne një punë të madhe.

Jehona Oruçi, drejtoreshë në shkollën “Faik Konica”, falënderoi drejtoreshën e DKA-së që kërkesat tona janë realizuar. Janë bërë disa investime, të cilat për neve kanë qenë mjaft bazike, edhe pse ka qenë vit i rëndë pandemik, dhe ne tani i kemi kushte në shkollë të cilat janë normale dhe janë të mjaftueshme me kryer procesin në mënyrë normale.

Tani në shkollën “Faik Konica” është duke u realizuar rregullimi i oborrit, hapësirat e jashtme, në përgjithësi gjithë oborrin dhe janë mbjellë fidanë. Shqetësuese për mua është dyshemeja, që u përmend nga parafolësit, është hapësira te shkallët e shkollave të vjetra. Te ne shkallët janë të rrëshqitshme, kështu që nëse keni mundësi me bërë këtë intervenim se ka të bëjë me sigurinë fizike të personave.

Liridon Maliqi, drejtori i shkollës “Model”, e falënderoi drejtoreshën e DKA-së, duke thënë se pa përkrahjen e saj nuk do të kryheshin shumë projekte të cilat neve na kanë ndihmuar shumë.

Me sa e pashë unë, kishte buxhet sa kemi planifikuar, ishte një shumë e vogël e fondit për shkolla të reja, nuk e di a është fjala për shkolla te reja që do të ndërtohen prej fillimit, apo këto çka po flasim. Uroj të jetë për këto që po flasim.

Shkolla jonë prej vitit 2013 kur është fasaduar, asnjëherë nuk është ngjyrosur nga jashtë, nga brenda vet e kemi gëlqerosur, andaj nëse keni mundësi me buxhetin dhe kontratat e juaja, do

të ishte mirë të kryhet jashtë në tërësi, se nëse nuk lyhet 40% e fasadës është rrezuar. Unë ju garantoj se në vitin e ardhshëm do të shkatërrohet krejtësisht.

Po ashtu, që nga viti 2014 kur është hapur shkolla, rreziku është nga mbulesa e ish-Tjegullores, se është duke u dëmtuar, çdo ditë e më shumë është rrezik për nxënës. Ne e kemi bërë një propozim edhe me drejtorin e Kulturës, që aty të bëhet një muze për shkollat tona të Prishtinës.

- Po ashtu, të rrënohen rreth 5 ari hapësirë dhe 250 metra e gjatë e rreth 120 metra i gjerë, pra të lirohet hapësirë për shkollën apo për Komunën e Prishtinës, që të bëhet vendi për trajnime dhe rekrutim të mësimitdhënësve për tërë institucionet komunale dhe një kuzhinë komunale e madhe;

- Në atë zonë sipas kërkesave të komunitetit, të bëhet një çerdhe në atë hapësirë ose një shkollë e mesme;

- Gjithashtu, shtyllat anti-parking duhet të vendosen përreth hapësirave të shkollës.

- Hapësira që është ngjyrosur me të kuqe për biçikleta, është shlyer në tërësi dhe është bërë korsi e tretë;

- Ajo pjesë ka nevojë për "policë të shtrirë", për shkak se po rrezikohen fëmijët;

- Rregullimi i dyshemesë në hyrje të shkollës, se ai beton është duke u shkatërruar pranë pusetave në oborr;

- Në katin e parë, nga viti 2014 është vërejtur lagështia, po shkatërrohen muret duke u rrezuar tullat;

- Për kamerat e dimë se asnjëherë nuk ka pasur kontrata të mirëfillta;

- Ne kemi 600m² dhe kam vetëm 8 punëtorë teknikë, do të ishte mirë së paku 1 apo 2 punëtorë teknikë me na i siguruar;

- Kemi nevojë për mësues mbështetës apo psikolog mbështetës. Kemi kërkuar se kemi fëmijë me dëmtime të mëdha të hendikepuar dhe psiko - fizike, kështu që është nevojë e domosdoshme të kemi mësues mbështetës dhe të kemi psikolog çdo ditë në shkolla e jo një psikolog për dy -tri shkolla, dhe në të ardhmen edhe infermierët t'i kemi nëpër shkolla secila shkollë.

Betim Sylejmani, sa i përket kërkesave individuale, çdo herë kemi kërkesa të tilla, unë vetëm një kërkesë e kam, që me buxhetin e vitit 2022 me u bërë fasadimi i objektit nga jashtë, sepse ka shumë nevojë shkolla. Në pjesën e brendshme nga oborri i shkollës, asnjëherë nuk është intervenuar.

Tek investimet dhe përmirësimi i kushteve, ne vetëm mundemi me thënë faleminderit për DKA për këto dy vite çka ka bërë për të gjitha shkollat e Prishtinës.

Po ashtu, duhet t'i jepet një rëndësi më e veçantë në parashikimet e buxhetit, digjitalizimit të shkollave, sepse kemi arritur që deri në një masë ta digjitalizojmë shkollën, por pajisje me tabela aktive, me tabela të mençura që tani janë kërkesë e kohës.

Po ashtu, Komuna e Prishtinës e ka marrë një iniciativë shumë të mirë për ndërtimin e pishinës për nxënës në shkollën "Dardania", dhe ne nuk duhet të presim, ajo do të kryhet shumë shpejt, por do të ishte mirë të parashihet në buxhet dhe t'i paguhet gjithë nxënësve mësimi në notë në ciklin e ulët.

Shpresa Shala tha se ideja e ndërtimit të kësaj pishine kryesisht është ajo që me u përfshirë të

gjithë fëmijët e komunës së Prishtinës deri në ndërtim të disa të tjerave, që mendoj se duhet të vazhdojë ndërtimi i tyre dhe të gjenden parcela dhe të ndërtojmë edhe më tutje pishina.

Besim Gashi mësimdhënës i gjeografisë në shkollën "Dardania", shprehu pakënaqësi se në shkollën ku ai punon kanë sjellë ushtrues detyre, që është kundër udhëzimeve administrative që janë nga MASH-i.

Sipas Udhëzimit administrative, që ju e dini, duhet të jetë mësimdhënësi i asaj shkolle, ndërsa në shkollën tonë na sjellin nga shkollat e tjera, andaj kërkoj shqyrtim e saj.

Shpresa Shala tha se komisionet për zgjedhjen e drejtorëve e bënë kryetari i Komunës, përzgjedhjen e bënë komisioni, i cili zgjidhet nga kryetari i Komunës e kontratën e nënshkruan vetëm kryetari i Komunës, e kjo i bie se DKA nuk është e përfshirë, janë komisionet që ju mundeni me u drejtuar me ankesa nëse mendoni që keni të drejtë dhe i drejtoheni komisionit.

Besim Gashi si ushtrues detyre a nuk pati shkolla "Dardania", pse nuk e ke bërë të kësaj shkolle, pse me sjell të një shkolle tjetër?!

Shpresa Shala tha se absolutisht nuk shkruan askund që duhet me qenë i shkollës "Dardania".

Besim Gashi a është në udhëzim administrativ?

Shpresa Shala absolutisht jo, nuk është as me bërë ushtrues detyre, as drejtor.

Debati përfundoi në ora 15:30.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

**të dëgjimi publik për planifikimin e buxhetit për vitin 2022, mbajtur më 28.07.2021,
me fillim në orën 14:00.**

Në diskutim ishin të pranishëm: Valbona Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave dhe Bujar Gashi, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë.

Valbona Makolli i përshëndeti të pranishmit, duke i falënderuar për pjesëmarrje në dëgjimet publike për planifikimin e buxhetit për vitin 2022, gjegjësisht për investimet kapitale që lidhen me sektorin e shëndetësisë.

Bujar Gashi, i falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje në dëgjim publik për planifikimin e buxhetit. Ai tha se kjo është praktikë e Komunës së Prishtinës, me përjashtim të vitit të kaluar, që nuk është mbajtur për shkak të pandemisë, por ka qenë online. Në vitin 2019 e kemi mbajtur bashkë dhe atëherë kanë dalë disa kërkesa nga ana juaj, që kanë qenë të rëndësishme, të cilat jemi munduar t'i aplikojmë në buxhet. Planifikimet buxhetore të vitit 2020 – 2021, për 2020-ën, përkundër gjendjes që kemi pasur me pandemi, jam falënderues gjithmonë edhe unë edhe Komuna e Prishtinës, se flas në emër të Kabinetit të Kryetarit, ju jemi mirënjohës për krejt punën që keni bërë jo vetëm në pandemi.

Si Drejtori e Shëndetësisë dhe Komunë, nuk jemi ndalur veç në atë drejtim, por kemi zhvilluar edhe projekte të tjera kapitale, siç e dini, QMF në Veternik veç është në ndërtim e sipër dhe planifikohet deri në fund të vitit të përfundojë komplet si projekt, e nga viti i ardhshëm do ta keni plus një QMF, ku janë afër 30 mijë banorë në atë zone dhe nuk kanë qasje në shërbimet shëndetësore.

Vitin e ardhshëm i kemi projektet të cilat ndoshta nuk kanë mundur me u zhvilluar. Nga projektet është edhe zgjerimi i garazheve të QMU- së, të cilat nuk janë të përfunduara ende dhe nuk ka mundur me u realizuar në 2021, por ajo mund të jetë si pikë e investimeve kapitale për vitin e ardhshëm, ndërsa për projektet të tjera të investimeve kapitale, drejtoresha mund të na sqarojë edhe pak sa i përket vendimeve të nivelit qendror, sepse ju e dini se për miratimin e buxhetit bëhen planifikimet dhe këto dërgohen deri në fund të muajit shtator, mirëpo ato duhet të

miratohen nga niveli qendror, janë disa korniza që na i dërgojnë paralelisht, prej të cilave nuk mundemi me lëvizë shumë.

Valbona Makolli theksoi se sot jemi për t'i dëgjuar kërkesat e stafit të shëndetësisë, mirëpo kërkesë e Ministrisë së Financave është që edhe ato projekte të cilat për arsye të ndryshme, sidomos arsyeja e pandemisë, kanë mbetur pa u realizuar, mundësisht ato të vazhdohen, d.m.th. ato projekte që kanë shkuar një herë, vetëm vazhdohen edhe një herë për vitin 2022.

Rrezart Halimi, ushtrues detyre i drejtorit të QKMF-së në Prishtinë, falënderoi të gjithë të pranishmit për mundësinë e dhënë për të diskutuar. Falënderimi për pandemi është reciprok, edhe për ju që në çdo moment keni qenë të gatshëm të na ndihmon në kërkesat tona si QKMF, në plotësimin dhe ofrimin e kushteve sa më të mira për qytetarët e Prishtinës në luftimin e pandemisë, deri te realizimi i projekteve të fundit, që ishte edhe ofrimi i insulinave, ku qytetarët e komunave tjera nuk e kanë pasur këtë fat e tash e kanë.

Brenga jonë më e madhe gjithmonë ka qenë rehabilitimi i objekteve ekzistuese, andaj kërkojmë të rritet buxheti në renovimet e objekteve ekzistuese, siç tha edhe drejtori, e kemi edhe një objekt i cili është në ndërtim e sipër në Veternik, dhe në këtë mënyre ne e përmbylлим rrethin, d.m.th. të MF-së, po ashtu edhe mirëmbajtja e objekteve ekzistuese jep një pasqyrë shumë të mirë.

Isuf Bajrami theksoi se përveç QKMF-së edhe QMU-të janë përkrahur në përballimin me gjendjen e pandemisë, na keni përkrahur në çdo kërkesë që kemi pasur, andaj dhe jemi falënderues.

Sa i përket zgjerimit të garazhit, kjo është nevojë e kahershme.

QMF që do të ndërtohet në Veternik, është nevojë e kahershme. Propozoj që në atë pikë të mendohet për një ekip mjekësor nga QMU, ne kemi nevojë me u rritur numri i stafit edhe në QMU edhe QMF, sepse çdo vit po rriten kërkesat, por në bazë të mundësive buxhetore dhe pëlqimi eventual nga Ministria, sepse tash për tash nuk lejohet.

Fatos Aliu i falënderoi të gjithë për kontributin e dhënë. Ai shprehu falënderim edhe për gatishmërinë e treguar për kërkesat e vazhdueshme si për material për COVID -19, si për produkte në të gjitha format që i kemi pasur, për kontratat që i kemi për produktet që i kemi në sasi të kufizuara në kontratat aktive. Njëherësh kisha dëshiruar që këto kontrata të lidhen prapë dhe të bëhet rritja e sasisë së këtyre produkteve.

Agron Kamberi, shef i Laboratorit, theksoi se synimet i kemi arritur në bashkëpunim me Drejtorinë komunale, ku bashkëpunimi ka qenë në nivel. Në të ardhmen, kemi planifikimet ta rrisim spektrin e analizave. Gjatë kohës sa ka qenë pandemia, kemi dalë në ndihmë me analizën dedimer, me teste stereologjike, falë bashkëpunimit me kryetarin e Komunës, me drejtorin e Drejtorisë së Shëndetësisë, dr. Bujarin, dhe menaxhmentin.

Njëherësh falënderoj edhe punonjësit e laboratorëve që kanë punuar me përkushtim. Aparaturat i kemi në rregull, do të kërkojmë rritjen e spektrit të analizave, kështu që kompletohem si spitali.

Rrezart Halimi parashtroi pyetje në vazhdim: Nëse ndodh valë e re e pandemisë, a është menduar ndonjë buxhet rezervë për material e për të tjerat, përveç buxhetit që e kemi të planifikuar?

Bujar Gashi tha se po përgjigjem shkurt. Po filloj nga drejtori Rrezart. Është e nevojshme t'i kushtohet një rëndësi e veçantë buxhetit për renovimet në institucionet shëndetësore, gjë që e kam parë edhe unë gjatë këtij mandati 3-vjeçar, se është një numër i madh i objekteve që janë të

ndërtuara vite më parë dhe të cilat janë shumë të dëmtuara, e që duhet t'i kushtohet një rëndësi e veçantë.

Buxheti vjetor për renovimet e objekteve shëndetësore është 150 mijë euro, kontrata e cila është nënshkruar vitin e kaluar për renovim, në vlerë totale 450 mijë euro, do të shfrytëzohet në renovimin e tri objekteve QMF-5, AMF në Bardhosh, që ka dalë si projekt i paplanifikuar, dhe QMF-4, ndërsa buxheti prej 150 mijë euro do të mendohet të rritet për inicimin e kontratës.

Çështjen e doktor Isufit për zgjerimin e garazheve, unë e përmenda që është projekt që duhet me dalë konkursi. Unë jam në pritje të daljes së konkursit, se duhet me u projektuar, do të bëhen garazhet e mbyllura, varësisht prej projektit qysh është planifikuar, nëntokësor, dhe do të bëhet një zgjidhje. Po ashtu, në vitin e kaluar në Urgjencë është rinovuar komplet urgjenca dhe ajo që është bërë ma shumë është hapja apo shkëputja e rrugës dha kalimi direkt në rrugën tjetër që ka qenë një projekt - kërkesë nga viti 2014-2015 dhe vitin e kaluar është realizuar.

Për ekipin në Veternik do të mendohet, sepse për me krijuar një ekip duhet së paku 15 punëtorë shëndetësorë ekstra për me krijuar një ekip plus, ajo e prek direkt numrin e punëtorëve që e kemi kufirin e limituar prej 871 komplet në Drejtorinë e Shëndetësisë, por duhet bërë kërkesë dhe shfrytëzohen instancat nëse do të lejohet rritja e numrit të punëtorëve.

Barnatorja, Fatos, te kontrata, një takim e bëni me menaxherin e kontratës, besoj ju jeni menaxheri, dhe e paraqitni një plan se deri ku ka arritur shfrytëzimi i kontratës, se është përqindja e shfrytëzimit të kontratës nëse jemi në kuadër të kornizës ligjore, për shkak se e di problemin, e kemi diskutuar sa herë, artikuj të caktuar që kanë munguar nga Ministria e Shëndetësisë, ne veç i kemi, dhe nuk e kemi mundësinë për shkak të Ligjit të prokurimit, me shpenzuar më shumë se sa lejohet për artikuj të caktuar që është duke na furnizuar Ministria, ndoshta edhe 10 vjet nuk i shfrytëzojmë e kontrata është kornizë, e ka afatin e caktuar 3 vjet, kështu që nuk do të lejojmë të mbesim pa barna, pa materiale esenciale. Caktoni një takim ju me drejtorin e Shëndetësisë, me shefin e Sektorit, me Prokurimin dhe të shihni ku jeni, të vazhdojmë me kontratë të re, nuk lejojmë më, ke treguar herën e fundit, prej 200 e më shumë artikujve që ke kërkuar, je furnizuar më pak se 50 artikuj, d.m.th. po na mungojnë rreth 180 artikuj furnizim nga Ministria, kapacitetet i kemi të limituara, buxhetin e limituar, nuk e kemi të pafund, d.m.th. ne nuk kemi kapacitet me i mbuluar krejt vitin qytetarët e Prishtinës me insulina, sepse na kushton rreth gjysmë milioni e nuk i kemi rreth gjysmë milioni për atë projekt.

Laboratori, është bërë një punë e jashtëzakonshme në vitin 2020, kanë qenë të angazhuar si gjithë të tjerët, në vijën e parë, me teste sterilogjike, rreth 28 mijë testime nëse nuk gabojmë, motra Kimete i ka mbajtur evidencat, rreth 23 mijë teste antigjenike, mbi 12 mijë teste dedimerit, mbi 120 mijë shërbime që janë ofruar në QMF-7, shërbime prej gushti deri tani për pacientët për COVID 19, është bërë një punë e jashtëzakonshme. Doktor Agron, me kërkesën tuaj, ne jemi furnizuar sivjet edhe me T- hormone T 3, T 4, T - H antigjeni, për herë të parë në Prishtinë në kujdesin parësor shëndetësor realizohen këto teste për qytetarët e Prishtinës.

Ju falënderoj për angazhimin e jashtëzakonshëm edhe 2019 -2020 dhe 2021, dhe ju inkurajoj të vazhdoni me këtë ritëm. Fillimisht ju falënderoj për bashkëpunim, që gjithmonë keni qenë në koordinim të plotë me Drejtorinë e Shëndetësisë, me Komunën e Prishtinës, ne jemi munduar dhe

kemi bërë sa kemi mundur, ky ka qenë kapaciteti im si drejtor. Falënderoj drejtoreshën për bashkëpunim, Kabinetin e kryetarit dhe kryetarin, pa të cilin nuk kishim mundur me arritur asgjë.

Valbona Makolli bëri të ditur se as vjet, as sivjet nuk kemi të drejtë me paraparë diçka për COVID 19, mirëpo pasi që e dini edhe vjet, edhe sivjet na e kemi pasur të njëjtën pyetje në Ministri të Financave, ata në bashkëpunim me IKSHPK-në, në momentin që bëhet një rritje e rasteve me COVID 19 dhe mungojnë mjetet buxhetore, do të kërkojmë rishikim të buxhetit dhe ato investime kapitale që na merr mendja që munden me prituri, nuk janë urgjente ose që nuk ka filluar ndonjë procedurë rreth tyre, ato bien dhe merren mjetet sikur vitin e kaluar, që i kemi aty ku kemi mundur, janë përcjell dhe çdo herë kur kemi raste emergjente, varet prej nivelit qendror dhe menjëherë, me kërkesën tonë, bëhet rishikimi i buxhetit çfarëdo faze, në qershor, zakonisht bëhet rishikimi, mirëpo në raste të COVID 19, rishikimi do të bëhet menjëherë dhe Ministria e Financave ka deklaruar se mjete shtesë ata i qesin vetë pa rishikim tonë.

Bujar Gashi i falënderoi të pranishmit për kohën dhe angazhimin. E di që keni lënë keq diçka për me ardhur këtu, por ia vlejti, dhe është shumë e rëndësishme që në të ardhmen mos të pendohemi për atë që planifikojmë ose ata që vijnë mbas neve të mos e kenë gjysmak këtë planifikim të buxhetit të vitit 2022.

Faleminderit shumë!

Debati përfundoi në ora 14:40.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

**të dëgjimi publik për planifikimin e buxhetit të vitit 2022, mbajtur më 29.07.2021,
me fillim në orën 14:00.**

Në diskutim ishin të pranishëm: Valbona Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, Vasilika Zotaj, drejtoreshë e Drejtorisë së Administratës, Habib Qorri dhe Dukagjin Gashi, zyrtarë nga Drejtoria e Shërbimeve Publik, Shkumbim Gashi, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Fadil Leci, udhëheqës i Sektorit të bashkësive lokale (BL-ve).

Valbona Makolli i përshëndeti të pranishmit, duke i falënderuar për kohën që kanë gjetur për të diskutuar lidhur me planifikimin e buxhetit për vitin 2022. Pra, ne sot jemi këtu për të ju dëgjuar juve lidhur me kërkesat të cilat i keni për BL-të që i përfaqësoni.

Vasilika Zotaj theksoi se këtu i kemi edhe udhëheqësit e sektorëve të fushave të ndryshme dhe për secilën pyetje që do ta parashtroni, përgjigjet do të jenë adekuate nga stafi i ekspertëve.

Ali Berisha, banorë i fshatit Siqevë, kërkesa e banorëve të lagjes ka të bëjë me Drejtorinë e Shërbimeve Publike. Para 4 viteve ka filluar ndriçimi i fshatit, por kanë mbetur 2 lagje pa u përfshirë në ndriçim dhe qe 3 vjet jemi duke pritur por nuk është duke u përfshirë në projektet në buxhet, andaj kërkojmë që të përfshihen edhe ato 2 lagje.

Valbona Makolli pyeti se ajo lagje a ka emra të rrugëve.

Ali Berisha tha lagjja te pjesa e poshtme e Siqevës, ndoshta si fshat është shumë afër qytetit prej shkollës "Ilmi Rakovica", 6 km dhe nuk ka ndriçim. Ka lagje që mbas 2010 janë krijuar dhe është bërë ndriçimi, shtrimi i rrugëve në kubze. Krejt çka është bërë brenda 20 vjetëve në fshat, është vetëm rruga e asfaltuar dhe ajo është kryer shumë vonë.

Për Drejtorinë e Investimeve kapitale, ka filluar një lagje ndërtimi i urës dhe ka përfunduar shtrimin e lagjes me kubze, kurse në 8 lagje të tjera nuk ka vazhduar projekti qe 3 vjet, me i përfshi ato 5 lagjet, nuk janë as 2 km.

Kërkesa tjetër ka të bëjë me transport. E kemi një transport jo publik, edhe pse është 3A, 3B, 3C

përfshihen ato pjesë, ne jemi ngjitur me Bardhosh, mbi Bërnice të Epërme, dhe ne e kemi transport privat, që nuk po i plotëson kërkesat, sidomos të fëmijëve që përfundojnë shkollimin fillore dhe fillojnë shkollimin e mesëm, si alternativë e kemi vetëm Bardhoshin dhe me 7B, Llukarin, dhe e kemi larg 3-4 km një drejtim. Kishte qenë mirë që 3C me zgatur linjën edhe 3 km me ardhur deri te shkolla dhe me përfshirë atë pjesë pikërisht në lagjet që nuk ka as ndriçim as rrugë me kuze, është numri më i madh i banorëve që jetojnë aty. Kam qenë në drejtoritë përkatëse kam biseduar me persona përgjegjës, kam bërë kërkesa çdo vit, më kthehet përgjigje me shkrim, duke thënë shikojmë buxhetin e vitit të ardhshëm, por u bënë 4 vjet dhe asnjë investim. Kam informacione që një lagje është përfshirë për vitin 2021, por në terren nuk kanë dalë askush me punuar, mirëpo për vitin 2022 të mos na ikën kjo mundësi.

I kemi 2 km rrugë që me kubze mund të shtrohen, dhe 5 ura për t'u ndërtuar. Deri në Bërnice janë ardhur me instalim të ujit, me pastrimin e lumit të fshatit me gjitha investimet që janë bërë si Komunë, por 2 km më lart nuk është duke lëvizur asgjë në këtë drejtim.

Aferim Berisha theksoi se i përfshiu të gjitha parafolësi, jemi nga i njëjti fshat, por mbesim me shpresë që të na bëhet një zgjidhje lidhur me çështjen e transportit.

Habib Qorri dha sqarime, duke cekur se te çështja e ndriçimit, vitin e kaluar nuk kemi pasur mundësi për shkak të procedurave të tenderimit, por në momentin që lidhet kontrata, aty ku e kemi lënë ndriçimin do të vazhdojmë, edhe ato pjesë që i përmendet ju janë të përfshira në projekt, por do të shkojë me vite, sepse ndriçimi nuk është vetëm te Siçeva, kemi edhe pjesë të qytetit pa ndriçim, por gjithmonë kemi shkuar që ato mjete që janë të parapamë me i shfrytëzuar në qytet dhe pak nëpër fshatra, nuk janë ndarë lagje me qëllim, nuk janë diskriminuar.

Sa i përket transportit në bazë të asaj që kemi pasur buxhet, gjatë këtij viti është përfshirë transportit publik që lidhet me trafikun urban, ne kemi lëshuar linjën, tani është një formë tjetër e operimit të transportit, jeni munduar me organizuar edhe sektorin privat, në mënyrë që operatori të mos ketë dallime dhe e shfrytëzon transportin, ne kemi shkuar në ato linjat që edhe ju i përmendet 3A, 3B, 3C kanë mbetur që vitin tjetër në bazë të planit dhe riorganizimit të transportit publik, të përfshihen edhe lagjet tjera të qytetit. Është e pamundur me i përfshirë të gjitha me transport publik, por edhe transporti privat të shkojë me të njëjtin status si transporti publik.

Po ashtu, është projekti gati në fazën përfundimtare që të shtohen edhe 30 autobusë për transportin publik.

Ali Berisha pyeti se a përfshihen ato lagje për ndriçim me planifikimet për vitin 2021.

Habib Qorri theksoi se për ndriçim jemi duke e pritur lidhjen e kontratës.

Ali Berisha tha se më mirë është një fshat kurë të merret një vite të përfundoj me ndriçim ai fshat, e jo një lagje 3 vjet ndriçim e tjetra në errësirë.

Çështje tjetër, ne jemi banorë të fshatit, diskutojmë krejt përfaqësuesit e lagjeve, te ne ka qenë qëllimi që nëse bëhet shtruarja me kubze në një lagje, në lagjen tjetër ndriçimi, që të dy lagjet me përfituar diçka, këtu ka shkuar e kundërta, në një lagje kanë shkuar dy investimet e lagjen tjetër kanë mbetur pa ndriçim dhe pa rrugë.

Habib Qorri tha se kur kemi shkuar te zgjerimi i ndriçimit, nëse shikojmë vetëm me Siqevë, atëherë janë edhe fshatrat tjera, lagjet tjera që mbesin, prandaj sa here që kemi pasur kontrata për zgjerimin e ndriçimit i kemi prekur të gjitha lagjet.

Vasilika Zotaj tha se edhe unë jam interesuar se edhe lagja ime është pa ndriçim, por këtu është çështja e kontratës.

Ali Berisha theksoi se prej vitit 1972 kurë është instaluar tensioni i lartë i rrymës elektrike, në 1985, në këtë fshat më asnjëherë nuk është bërë investim në instalim të rrymës në ato shtylla, në ato trafo, sa banorë kanë qenë e sa janë tani me rritjen e numrit të banorëve dhe pajisjeve, ende jemi në ato 2 trafo, ku kemi tension të ulët të rrymës, edhe aty kërkohet një investim.

Pse mos ta ketë të paktën çdo lagje nga një trafo?!

Habib Qorri dha sqarime, duke thënë se kem informatë nga KESKO, se kemi bashkëpunim për shkak të projekteve tona, kjo është përgjegjësi e KESKO, te zhvillimi i infrastrukturës në rrjetin elektrik, është më tepër e fokusuar në zonën urbane, por me përfundimin e kësaj kanë me kaluar në pjesën e fshatrave.

Afrim Berisha theksoi se jemi në hall të madhe për transport për Siçevë. Tash e 20 vjet e kemi vetëm një kombi dhe ai kombi nuk i ka plotësuar kushtet, kërkesat e banorëve.

Habib Qorri dha sqarime lidhur me këtë.

Violeta Hasani, përfaqësuese e zonës Qendër, u shpreh se unë sot jam këtu vetëm për shqetësimin e qytetarëve, për zhurmat e kafeterive, për çka jeni njoftuar shumë herë. Janë disa lokale të cilat i kanë shqetësuar qytetarët me zhurmën e krijuar, por tani kanë filluar edhe me kërcënime ndaj banorëve. Në javën e kaluar ka qenë një konflikt në mes të banorit dhe biznesit që vepron aty. Nuk e di me çfarë kushtesh lejohet muzika e gjallë në mes të oborrit kolektiv! Për këtë janë të informuar edhe policia dhe e kom dërguar e-mailin te kryetari. Ju lutem merrni masa ndaj këtij biznesi që po iu sjell telashe banorëve.

Dukagjin Gashi tha se kjo nuk ka lidhje me buxhet, tani e kemi drejtorin e Inspeksionit, që për çdo rast interevenon së bashku me policinë dhe ato i adresoni. I vetmi institucion të cilit mund t'i drejtohet me ankesë çdo qytetar për çdo problem të natyrës së tillë, është në Inspeksioni dhe Policia.

Violeta Hasani falënderoi zyrtarin e Shërbimeve Publike, z. Dukagjin Gashi, të cilit i kishte adresuar e-mail, i cili është treguar i përgjegjshëm, duke ma ka kthyer e-mailin brenda ditës, se janë rregulluar dy pika kontejneri, të cilat e kanë tjetërsua lagjen, dhe e falënderoi për korrektësinë që tregon ndaj qytetarëve.

Selatin Gashi, banorë i lagjes "Qendra", theksoi se bashkëpunojnë me znj. Violeta për të mirën e gjithë banorëve. Sa i përket këtyre gjërave që i përmendi, unë kam edhe më shumë, e dinë zyrtarët e Shërbimeve Publike se çka kam bërë unë për atë lagje. Unë banoj te Banka e Lubllanës, te Kafet e Vogla, zhurma që bëhet nuk ka koment. Kjo është e palejueshme. Unë e kam rregulluar parkun pas Bankës së Lubllanës, jam duke e mbrojtur se kanë tentuar me shndërruar në parking, nuk e lejoj se është pronë e banorëve. E përkrah shumë Violetën, unë kisha pasur dëshirë me qenë prezent edhe kryetari, nënkryetari, me iu drejtuar se nuk jeni duke bërë asgjë për mirëqenien e qytetarit. Nuk është problem këtu vetëm zhurma që u përmend, është parkingu, janë shumë gjëra, kështu që duhet bashkëpunim sa më i afërt me qytetarë. Problem tjetër është, nuk e di a jeni në dijëni, kurë është shtruar rruga "Stambolli", ku jetoj unë, është vendosur gypi i ujit vetëm 40 cm nën trotuar, nuk ka ujë në këtë rrugë, edhe ai ujë që vije nuk ki mundësi me pi për shkak të nxehtësisë së tij. E kam paraqitur rastin, kanë ardhur ekipi nga ujësjellësi "Batllava", më kanë

thënë se vendosja e gypit i përket Komunës. Po ashtu, është një rrugë aty në gjendje të keqe, nuk vie kush për ta rregulluar, është një distancë 250 metra rrugë ku ndriçim nuk ka.

Shqipe Shkodra pyeti se me sa të drejta ligjore, ku po shkruajnë ato rregulla që me iu dhënë në shfrytëzim individual pronarëve të kafeterive gjelbërimin që është përpara banesave, që ai gjelbërim është dedikuar për 14 familje që jetojmë në atë hyrje, njëkohësisht trotuari komplet iu ka dhënë kafiterisë dhe po e shfrytëzojnë, e ne qytetarët duhet me dalë në rrugë kryesore me penguar qarkullimin e automjeteve?

Çështje tjetër është se a duhet vazhdimisht qytetari me u viktimizua për shkak të një kafiterie që ai duhet me punuar?! Komplet Qendra është e shfrytëzuar prej kafeterive, por ku jemi ne banorët, kah me kaluar, makinat para banesës nuk kemi të drejt me i lanë, nuk kemi mundësi, na është thënë pas orës 24:00 mund t'i sillni makinat para banesave!

Unë vazhdimisht kërkoj polic me ardhur me na ndihmuar, me na i zgjidhur problemet, shoku ka tentuar sa here me kontaktuar me komunarë, por përgjigja është se janë të zënë, policët nuk kanë mundësi se janë pak ekipe nëpër terren, nuk po munden në moment me intervenuar, ne nuk po dimë ku me shkuar me u ankuar. Policia po thonë Komuna duhet me ua vënë drynin. Tri herë nëse ka ankesë, sipas ligjit dhe rregullores, për një problem të njëjtë, Komuna duhet me ia vënë drynin, Komuna është për të kontribuar kundër këtyre të këqijave.

Po ashtu, tha se nuk ka inspektorë, çdo natë i thirri inspektorët, nuk ka inspektorë me ekipe urgjence! Unë pe thirri 112, Komunë ju them a ka mundësi me na dërguar ndonjë inspektor me rishikuar çka po ndodhë, ka rrahje, jo, më vjen keq, vetëm në mbrëmje nuk ka inspektorë, nuk jeni vetëm ju, Prishtina është e madhe. Kush e ka bërë pra këtë tollovi, jo qytetarët por lejet e tepruara.

Debati përfundoi në ora 15:05.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina



EKSTRAKT I PROCESVERBALIT
të dëgjimi publik për planifikimin e buxhetit për vitin 2022, mbajtur më 30.07.2021,
me fillim në orën 14:00.

Në dëgjim publik morën pjesë drejtoresha e Drejtorisë së Financave, Valbona Makolli dhe Habib Qorri, përfaqësues i Shërbimeve Publike.

Valbona Makolli i përshëndeti të pranishmit, duke thënë se çdo kërkesë e juaja sot lidhet me investimet kapitale që ua merr mendja për vitin 2022 dhe ndonjë investim kapital që keni nevojë me paraqitur në Komunën e Prishtinës janë të mirëseardhura.

Hafiz Krasniqi nga LDK, paraqiti disa kërkesa:

- Kanalizimi Llukar-Makovc - Grashticë (vazhdimi i projektit) të mëparshëm;
- Zgjerimi i rrugës Prishtinë- Grashticë (4 korsi);
- Ndërtimi i rrugës nga Lagjja Berishaj - Butoc ose lagjja Brahimaj - Butoc, si atraksion turistik), ashtu siç e parashohin ekspertët;
- Ujësjiellësi Bërnice - Siqevë;
- Vazhdimi i ujësjiellësit nga Makovci - Grashticë dhe Lagjja Ugria.

Valbona Makolli i falënderoi pjesëmarrësit që kanë gjetur kohë me ardhur në dëgjim publik.

Debati përfundoi në orën 14:20.